

Statistikat afatshkurtra

Shërbimet - Tremujori IV, 2017


Tiranë, më 16 Mars 2018: Treguesit tremujorë mbi shërbimet, përfshijnë aktivitetet ekonomike: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; Transport, Magazinim dhe Postë; Hotele; Informacioni dhe Komunikacioni; Aktivitete të Arkitekturës dhe Inxhinierike dhe Agjenci udhëtimi, në tremujorin e katërt 2017, paraqiten si më poshtë:

Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave

Indekset e treguesve në aktivitetin Tregti, e cila përfshin tregti me shumicë, tregti me pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave, në tremujorin e katërt 2017, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 2,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rënie 0,2 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Tregti (%)




Transport, Magazinim dhe Posta

Indekset e treguesve në aktivitetin Transport, Magazinim dhe Posta, i cili përfshin transportin Hekurudhor të mallrave, Detar, Ajror, Magazinimin dhe aktivitetin Postar, në tremujorin e katërt 2017, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 4,8 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 3,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 2,6 %, krahasuar me krahasuar me tremujorin e katërt 2016.

Fig. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Transport, Magazinim dhe Postë (%)




Hotele

Indekset e treguesve në aktivitetin Hotele, në tremujorin e katërt 2017, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 6,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 3,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 14,2 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016.

Fig. 3 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Hotele (%)




Informacion dhe Komunikacion

Indekset e treguesve në aktivitetin Informacion dhe Komunikacion, i cili përfshin aktivitetin e Publikimit, Telekomunikacionit si dhe shërbimet e Teknologjisë së Informacionit, në tremujorin e katërt 2017, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 7,6 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 1,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 0,7 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016.

Fig. 4 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Informacion dhe Komunikacion (%)




Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike

Indekset e treguesve në aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike, i cili përfshin aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike, aktivite të Kontrolleve dhe Analizave teknike, në tremujorin e katërt 2017, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 8,7%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 2,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rënie 1,7 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016.

Fig. 5 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike (%)




Agjenci udhëtimi

Indekset e treguesve në aktivitetin Agjenci udhëtimi, në tremujorin e katërt 2017, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 5,8 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 22,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 9,0 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016.

Fig. 6 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Agjenci udhëtimi (%)



Tab. 1 Indeksi i Shitjeve neto në volum, Shërbime (2010=100)

NVE Rev.2		Aktiviteti ekonomik	Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja		Tr.IV 2017 (2010=100)	IV.17 / IV.16 (%)	Tr. IV 2017 (2010=100)	IV.17 / III.17 (%)
G	45+46	Tregti	146,2	1,0	136,2	-0,9
H	49-53	Transport dhe Magazinim	39,9	-4,8	39,4	-6,1
I	55.1	Hotele	155,6	6,5	160,3	-2,7
J	58, 61, 62	Informacioni dhe Komunikacion	86,8	-7,6	72,9	-12,0
M	71	Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike	116,0	8,7	111,7	-8,0
N	79	Agjenci udhëtimi	231,2	5,8	223,2	-9,2

Tab. 2 Indeksi i numrit të të punësuarve dhe fondit të pagave, Shërbime (2010=100)

NVE Rev.2		Aktiviteti ekonomik	Të Punësuar		Fondi i pagave	
Seksioni	Ndarja		Tr.IV 2017 (2010=100)	IV.17 / IV.16 (%)	Tr.IV 2017 (2010=100)	IV.17 / IV.16 (%)
G	45+46	Tregti	197,7	-2,7	203,6	-0,2
H	49-53	Transport dhe Magazinim	107,9	3,8	82,7	2,6
I	55.1	Hotele	119,0	3,2	147,0	14,2
J	58, 61, 62	Informacioni dhe Komunikimi	86,8	-1,8	131,4	0,7
M	71	Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike	150,7	-2,6	178,0	-1,7
N	79	Agjenci udhëtimi	289,6	22,6	309,0	9,0

Shënime metodologjike

Informacion mbi vrojtimin

Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

Në Shërbime

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën tremujore pranë ndërmarrjeve të Shërbimeve, janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (45) dhe Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave (46)
- Transporti dhe Magazinimi (përfshirë edhe Aktiviteti Postar dhe korrierës) (49-53)
- Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor, përfshi vetëm Hotele (55,1)
- Informacioni dhe Komunikacioni (58, 61, 62)
- Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike (71)
- Agjenci udhëtimi (79)

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarjet me 1 - 9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht,

Mbledhja e informacionit - Mbledhja e të dhënave bëhet me intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2010=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash, Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtë vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

Përkufizimet e treguesve kryesorë

Shitjeve neto - Shitjet neto përfshijnë shumat faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

Indeksi i Shitjeve neto - Objektivi i indeksit të Shitjeve neto është të paraqesë ecurinë e tregut për shërbime.

Numri i të punësuarve - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përjashtuar të vetëpunësuarit me pagesë),

Indeksi i Numrit të punësuarve - Paraqet ecurinë e punësimit në njësitë e vrojtuar.

Paga dhe trajtime - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimit (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

Indeksi i fondit të pagave - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.

Përshtatja sezonale

Përshtatja sezonale në seritë tremujore të Shërbimeve zbatohet duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.1. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2005 - Tremujori III 2017. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishhtë (multiplikative). Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave tremujore. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.